



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1090 Prot.

Tiranë, më 23 / 07 / 2020

**V E N D I M**

**Nr. 76., Datë 23 / 07 / 2020**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, mori në shqyrtim ankesën me nr. 36 Regj., datë 26.05.2020, të shtetasit R. M, kundër Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Fushë Krujë, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*bindjeve fetare*”<sup>2</sup>.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

**KONSTATOI:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Referuar ankesës të sjellë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shtetasi R. M është shprehur se është diskriminuar nga punonjësi i kësaj IEVP-je, z.Xh. D, pasi ai e shqetëson dhe pengon në ushtrimin e të drejtës së tij për të realizuar ritin e faljes, bazuar në bindjet e tij fetare, si besimtar dhe aplikant i fesë myslimane.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Ankuesi deklaron se është besimtar dhe praktikant i fesë myslimane.

<sup>3</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të marrë në shqyrtim ankesën e tij.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>4</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

---

<sup>4</sup>Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

1. Me shkresën me nr.580/2 prot., datë 01.06.2020 Komisioneri i ka kërkuar informacion IEVP Fushë-Krujë lidhur me pretendimin e subjektit ankues R. M.

➤ Nëpërmjet shkresës me nr.1462 prot., datë 08.06.2020 IEVP Fushë-Krujë, ka dërguar parashtrimet e saj lidhur me pretendimet e subjektit ankues, duke cituar se:

*“Shtetasi R. M ndodhet i akomoduar në IEVP Fushë-Krujë, i dënuar me 6 vite e 6 muaj burgim, me Vendimin nr.108, datë 13.06.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për kryerjen e veprave penale të “Vrasjes me dashje e mbetur në tentativë”, “Armëmbajtje pa leje”. Subjekti ankues gjatë qëndrimit në IEVP Fushë-Krujë, ndjek dhe praktikon ritet fetare, mundësi kjo e krijuar nga ana e Institucionit tonë në zbatim të nenit 62, të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Komitetit Mysliman Shqiptar, ku çdo ditë të premte realizohet falja në ambjentet e kultit. Këto rituale aktualisht janë të ndërprera në zbatim të protokolleve shëndetësore Covid-19. Këto ambjente janë të miratuara për të realizuar këto veprimtari fetare.*

*Në IEVP Fushë-Krujë ka një numër të konsiderueshëm të dënuarish që praktikojnë ritet fetare në bazë të besimeve të tyre, vërtetuar kjo me listat e aktiviteteve fetare, të rifreskuara në zbatim të kërkesave të të dënuarve dhe të paraburgosurve. Këto rite fetare drejtohen nga përfaqësues të miratuar nga religjionet e tyre fetare, ku të gjithë të dënuarit dhe të paraburgosurit kryejnë ritet e tyre fetare gjatë një orari të caktuar dhe të miratuar nga Drejtoria e Institucionit.*

*Nga ana e Institucionit në bashkëpunim me përfaqësuesit e komuniteteve të ndryshme fetare gjatë gjithë kohës janë marrë masa për kremtimin e festave sipas kalendareve fetare duke punuar dhe me orare të zgjatura. Për të qenë konkret, citojmë festimin e Fitër Bajramit ku Komiteti Mysliman Krujë, ka sjellë pako ushqimore për të dënuarit dhe të paraburgosurit të cilët praktikojnë këto rite fetare. Shpërndarja është bërë nga punonjësit e Institucionit në bashkëpunim me të dënuarit dhe çdo gjë ka kaluar shumë mirë. Lidhur me shqetësimet e paraqitura nga ankuesi, Institucioni jonë me t’u njohur me këtë problem e ka vlerësuar atë dhe u kontaktua direkt i dënuari R. M. Ambjentet e miratuara për të ushtruar të drejtën e besimit për çdo të dënuar janë të monitoruara me kamera dhe afati i ruajtjes së pamjeve filmike është 30 ditë. Pamjet filmike për shkak të kalimit të këtij afati nuk mundësohen aktualisht. Këto ambjente që nga data 13.03.2020 dhe në vijim, nuk janë lejuar të shfrytëzohen për shkak të gjendjes së shkaktuar nga pandemia e Covid-19”.*

*Nga ana e IEVP Fushë-Krujë u parashtrua se, pasi dëgjuan pretendimet e të dënuarit R. M në lidhje me punonjësin XH.D, me qëllim që i dënuari të ishte i qetë në lidhje me trajtimin e pretendimeve të tij, u morën masa paraprake për shpërndarjen e kontakteve midis tyre, deri në*

dëgjimin dhe të punonjësit XH.D, duke e lëvizur nga vendi i shërbimit. Të dënuarit iu bë me dije nga ana e këtij Institucioni, se lidhur me këto pretendime do të pyetet dhe punonjësi XH.D.

Ndërkaq, lidhur me pretendimin e ankuesit ndaj punonjësit XH.D, IEVP Fushë-Krujë, thirri në takim në prani të Shefit të Policisë, Shefit të Personelit dhe të Juristit të këtij Institucioni, vetë punonjësin XH.D, duke i bërë me dije pretendimet e të dënuarit R. M.

Në shkresë sqarohet se punonjësi XH.D ka mohuar që nga ana e tij të kenë ndodhur veprime diskriminuese ndaj këtij të dënuari, duke bërë me dije se, për shkak të njohjes dhe lidhjeve që ka me të për arsye se banojnë dhe janë nga e njëjta zonë, në disa raste e ka toleruar atë.

Ndër të tjera, nga ana e IEVP Fushë-Krujë u theksua fakti se punonjësi XH.D ka një eksperiencë pune prej 34 vitesh në Policinë e Shtetit dhe Policinë e Burgjeve dhe gjatë gjithë kësaj periudhe nuk është ndëshkuar me masa disiplinore për shkelje të rregullave të shërbimit.

IEVP Fushë-Krujë, lidhur me subjektin ankues R. M, ka informuar KMD se: *“Ky shtetas në qëndrimin dhe sjelljen e tij në këtë Institucion, ka qenë dhe vazhdon të jetë konfliktual dhe i papërshtatshëm me bashkëvuajtësit. I dënuari ka qenë i akomoduar në ambjentet e veçimit për arsye mospërshtatjeje me bashkëvuajtësit. Sistemimi i tij në ambjentet e banimit ka qenë i pamundur, për shkak të sjelljes së tij shpesh agresive dhe të dhunshme që ka shfaqur ky i dënuar dhe si pasojë, ka krijuar konflikte në të gjithë sektorët e banimit. Këto problematika i ka manifestuar dhe në IEVP të tjera, sikurse rezulton nga aktet shkresore të përcjella pranë KMD. Përsa më sipër, ky i dënuar ka lëvizur/është transferuar nga IEVP Fushë-Krujë në Lushnjë, Peqin, Krujë dhe Fushë-Krujë..*

*I dënuari R. M është ndëshkuar tre herë me masë disiplinore në Institucionin tonë dhe aktualisht, për shkak të pamundësisë së sistemimit në godinën e banimit të të dënuarve është i akomoduar në ambjentet e Observimit”.*

Bashkëlidhur shkresës IEVP Fushë-Krujë ka depozituar kopje të dokumentacionit të kërkuar nga KMD.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me pretendimin e subjektit ankues për trajtim diskriminues nga ana e punonjësit XH.D.**

Ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë të padenjë dhe është diskriminuar nga ana e punonjësit të IEVP Fushë-Krujë, z.XH.D, përmes shqetësimit dhe pengimit të ushtrimit të ritit të faljes sipas besimit të tij fetar. Subjekti ankues nuk rezulton të ketë ushtruar të drejtën e ankimit të kësaj sjelljeje të pretenduar apo ta ketë adresuar atë pranë këtij Institucioni.

Personat e privuar nga liria kanë të garantuar ligjërisht mundësinë dhe gjithë mekanizmin për të ngritur një çështje, shqetësim, kërkesë dhe ankesë<sup>5</sup> nëse kjo është e nevojshme, kurdo që ata e gjykojnë se të drejtat e sanksionuara në ligje janë shkelur. Për këtë arsye, autoritetet e institucioneve penale duhet të ndërtojnë dhe të garantojnë funksionimin eficient të procedurave të kërkesë-ankesës, ku këto të fundit të shqyrtohen me seriozitet, efektivitet dhe në kohë.

Rregullorja Evropiane e Burgjeve lidhur me kërkesë ankesat e personave të privuar nga liria në sistemin e burgjeve sanksionon se: *“Të burgosurit, individualisht ose si grup, duhet të kenë mundësi të mjaftueshme për të bërë kërkesa apo ankesa drejtuar drejtorit të burgut ose ndonjë autoriteti tjetër kompetent. Nëse një kërkesë mohohet ose një ankesë refuzohet, të dënuarit duhet t’i ofrohen arsye dhe i dënuari do të ketë të drejtë të ankohet pranë një autoriteti të pavarur”.*

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) thekson se: *“Ankesa efektive dhe procedurat e inspektimit janë garanci themelore kundër keqtrajtimit në institucionet e privimit të lirisë. Personat e privuar nga liria duhet t’i kenë rrugët të hapura për t’iu drejtuar organeve si brenda dhe jashtë kontekstit të sistemit të burgjeve, duke përfshirë edhe mundësinë që të kenë qasje konfidenciale pranë një autoriteti të përshtatshëm”.*

Kjo e drejtë ka gjetur pasqyrim dhe në ligjin nr. 8328, dt. 16.04. 1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosur”, i ndryshuar. Konkretisht në nenin 8 të këtij ligji parashikohet se të dënuarit kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të bëjnë ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme dhe në mënyrë individuale.

IEVP Fushë-Krujë dhe DPB janë vënë në dijeni të pretendimit për diskriminim të ankuesit nëpërmjet korrespondencës zyrtare me Komisionerin.

Në këto rrethana IEVP Fushë-Krujë, ka bërë verifikimet përkatëse lidhur me pretendimin e ngritur nga shtetasi R. M.

Referuar shkresës me nr.1462 prot., datë 08.06.2020 të IEVP Fushë-Krujë dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, KMD është njohur me qëndrimin dhe provat e këtij Institucioni lidhur me pretendimin e shtetasit R. M.

---

<sup>5</sup> Ankesat i referohen kundërshtimit me shkrim ose me gojë, përkundrejt një vendimi, veprimi ose mos-veprimi të autoritetit të institucionit, me të cilin ata mund të mos jenë dakort.

Ankuesi pretendon se z.XH.D e ka shqetësuar dhe penguar atë në ritualin e faljes, duke bërë që ai të ndihej i diskriminuar. Nga ana tjetër, vetë IEVP Fushë-Krujë nëpërmjet dokumentacionit të sjellë mohon që një pretendim i tillë të jetë i vërtetë, dhe se z.M nuk e ka ngritur më parë këtë pretendim pranë Institucionit, qoftë me gojë apo me shkrim.

Po ashtu, referuar shkresës me nr.356 prot., datë 06.05.2020 të IEVP Fushë-Krujë, në vlerësimin e sjelljes të shtetasit R. M<sup>6</sup>, në konkluzionet përfundimtare citohet se: *“Për këtë periudhë 6-mujore, i dënuari R. M ka shfaqur sjellje dhe qëndrime jo korrekte, duke mos zbatuar etikën e komunikimit me stafin dhe me bashkëvuajtësit. Shfaq vetëkontroll të ulët në marrëdhëniet me stafin dhe bashkëvuajtësit”*. Ndërsa, tek rubrika “Besimi fetar/ndjekja e riteve fetare” është cituar se: *“Praktikon ritet e besimit musliman, frekuenton rregullisht ambjentet e kultit”*.

Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, në nenin 62 të saj ka sanksionuar se: *“Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe e besimit respektohen”* dhe se *“Programi institucional organizohet në mënyrë të tillë që për aq sa është e mundur t’u lejojë praktikimin e fesë dhe ndjekjen e besimit të tyre, marrjen pjesë në shërbesa apo mbledhje të drejtuara nga përfaqësues fetarë të miratuar nga institucioni, zhvillimin e takimeve me këta përfaqësues pa praninë e personelit të IEVP-së dhe mundësinë e mbajtjes së librave që lidhen me fenë apo besimin”*.

Bazuar në shkresën me nr. 3679 prot., datë 11.12.2019 dhe me nr.3702 prot., datë 13.12.2019 të IEVP Fushë-Krujë “Mbi organizimin e aktivitetit fetar”, konstatohet se nga ana e këtij Institucioni janë hartuar listat e të dënuarve dhe të paraburgosurve të planifikuar për të marrë pjesë në aktivitetet edukativo-fetare.

Emri i subjektit ankues, rezulton të jetë i përfshirë në këto lista. Bazuar në shkresën me nr.1462 prot., datë 08.06.2020 të IEVP Fushë-Krujë dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, rezulton që ambjentet e përcaktuara për kryerjen e ritualeve fetare janë ndaluar të shfrytëzohen për të gjithë të dënuarit dhe të paraburgosurit, në kuadër të masave të marra për parandalimin e përhapjes së Covid-19, ku dhe ankuesi nuk bën përjashtim. Pra, në këtë kontekst, trajtimi nga ana e këtij Institucioni ka qenë i njëjtë për të gjithë të dënuarit dhe të paraburgosurit.

Neni 10 i LMD ka përcaktuar se: *“Ndalohet diskriminimi lidhur me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, veçanërisht kur ka të bëjë me shprehjen e tyre individualisht ose kolektivisht, në public ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve.*

*Përjashtimi nga kjo dispozitë mund të lejohet vetëm kur ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive. Megjithatë, në çdo rast, lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së*

---

<sup>6</sup>Përperiudhën e qëndrimit në Institucion: 03.10.2019-03.04.2020. Procesverbal është firmosur nga Komisioni.

*ndërgjegjjes dhe fesë mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Përjashtimi për këtë shkak duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar nevojën për diskriminim. Në çdo rast lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjjes dhe fesë nuk mund të cënojë thelbin e lirisë dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”.*

Në kontekst të sa më sipër, nga IEVP Fushë-Krujë janë marrë masat për parandalimin e përhapjes së COVID-19 bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi: respektivisht në respektim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 7, pika 4, germa a) të ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, Vendimit datë 08.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri, Udhëzimit të ISHP, si dhe Udhërave të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale<sup>7</sup>, Instituti i Shëndetit Publik dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Komisioneri vlerëson se, masat e ndërmarra për pezullimin e kryerjes së ritualit të faljes në ambientet e përbashkëta ku ka grumbullime të aplikantëve/ të dënuar, në kuadër të sigurisë së shëndetit dhe jetës së të dënuarve që vuajnë dënimin me heqje lirie pranë kësaj IEVP-je, nga ana e këtij Institucioni janë objektivisht të arsyeshme dhe proporcionale në raport me situatën e krijuar në kuadër të pandemisë COVID-19 dhe për këtë shkak nuk mund të konsiderohen diskriminuese për asnjërin nga të dënuarit aplikantë të feve të tyre respektive, përfshirë dhe subjektin ankues.

Bazuar në shkresën me nr. 1462 prot., datë 08.06.2020 të IEVP Fushë-Krujë, rezulton se ndaj punonjësit XH.D nuk ka patur asnjë ankesë me shkrim as nga shtetasi R. M dhe as nga të dënuar të tjerë brenda këtij institucioni.

Në rastin konkret, në përfundim të analizimit të ankesës, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioneri, nuk arrihet të provohet se ka patur veprime fyese apo diskriminuese nga ana e z.XH.D ndaj ankuesit, që ta kenë ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo dinjitoz. Jemi në situatën kur nuk mund të provojmë apo të marrim si të mirëqena pretendimet e palës ankuese, se ka patur fyerje në drejtim të tij, për sa kohë ato janë të paprovuara shkresërisht, apo në mënyrë tjetër dhe mbeten në karakterin deklarativ. Kjo për shkak se nuk ka asnjë ankesë të depozituar nga ana e z.M drejtuar IEVP-së, që të mund të provonte që vërtet ka patur një konflikt apo dhunë verbale, mes punonjësit XH.D dhe ankuesit.

<sup>7</sup> Urdhër nr.132, datë 08.03.2020 dhe Nr.222, datë 01.04.2020 “Për mbylljen e aktivitetit publik dhe jopublik dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllyra apo të hapura”, të Ministrit të MSHMS.

Nga ana tjetër, një pretendim i tillë nuk mund të provohet përmes pamjeve audio-vizuale të kamerave të vendosura në IEVP, për shkak të kalimit të afatit 30 ditor të ruajtjes së këtyre pamjeve.

Neni 7 i LMD-së<sup>8</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 7/1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga ana e punonjësit të IEVP Fushë-Krujë XH.D apo vetë këtij Institucioni përmes mosveprimit.

Në mungesë të trajtimit të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Në përfundim, Komisioneri sjell në vëmendje të këtij Institucioni, të ketë në konsideratë që të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat njerëzore dhe ligjore të tyre.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, nenin 7/1, nenin 10, nenin 32, pika 1/c), si dhe nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit R. M, nga ana e punonjësit XH.D, pranë

---

<sup>8</sup>Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

IEVP Fshë-Krujë, për shkak të bindjeve të tij fetare.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Të mira dhe shërbime

Shkaku: Bindjet fetare